



MEMO SQARUESE

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) në mbledhjen e mbajtur me datën 20 shtator 2017, vendosi që në respektim të nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, të shpall për diskutim publik disa nene nga dy rregulloret në fuqi: Rregullorja KPM-2017/03 për Tarifën Vjetore për Licencë dhe Rregullorja KPM 2016/02 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.

I. RREGULLORJA PËR TARIFËN VJETORE PËR LICENCË KPM-2017/03

Rregullorja për Tarifën Vjetore për Licencë KPM-2017/03 do t'i nënshtrohet diskutimit publik vetëm për sa i përket nenit 11 "Tarifat vjetore për licencë për operatorët e shpërndarjes". Gjatë zbatimit në praktikë të kësaj Rregulloreje ka lindur nevoja për plotësimin e nenit 11 me dy paragrafë të rinj si më poshtë:

- 1.1. I licencuari që operon në të njëjtën kohë si operator kabllor dhe IPTV, por në të dy platformat shpërndan të njëjtat kanale, obligohet të paguajë vetëm një tarifë vjetore për shërbimet e njëjta të ofruara në të dy platformat e licencuara.
- 1.2. I licencuari që operon në të njëjtën kohë si operator kabllor dhe IPTV, por shpërndan kanale të ndryshme në të dy platformat e licencuara, obligohet të paguajë tarifën vjetore veçmas për operator kabllor dhe veçmas për IPTV.

II. RREGULLORJA PËR KOMUNIKIMET KOMERCIALE AUDIOVIZUALE KPM 2016/02

Rregullorja për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KPM 2016/02 do t'i nënshtrohet diskutimit publik vetëm për sa i përket nenit 11 "Kohëzgjatja e reklamimit televiziv dhe teleshopingut". Ndryshimet iniciohen bazuar në analizat e kërkesave të të licencuarve në lidhje me ndryshimin e rregullave të teleshopingut të përcaktuara në nenin 11 Rregullores KPM 2016/02 dhe i ka adresuar përmes nenit 11 ku janë bërë këto ndryshime:

1. Dritaret e teleshopingut nga 6, sa kanqenë, do të rritet në 8 dritare të teleshopingut;
2. Kohëzgjatja e përgjithshme e dritareve të teleshopingut brenda 24 orëve do të jetë 120 minuta, për dallim nga rregulli në fuqi i cili si kohëzgjatje të përgjithshme përcakton kohën prej 90 minutash;
3. Me ndryshimin e ri teleshopingu mund të transmetohet edhe në formë të spoteve të teleshopingut ku kohëzgjatja e një spoti, brenda një ore transmetim, nuk mund të jetë më e gjatë se 5 minuta.
4. Spotet e teleshopingut, për dallim nga dritaret e teleshopingut, do të llogariten në kohën e transmetimit prej 12 minutash brenda një ore transmetim ashtu siç është përcaktuar me nenin 11 të Rregullores në fuqi.

Sqarim: duke u bazuar në faktin se Rregulloret e lartpërmendura i nënshtrohen diskutimit publik vetëm sa i përket neneve të caktuara, KPM do t'i trajtojë vetëm komentet dhe sugjerimet të cilat kanë të bëjnë me çështjet e ngritura në kuadër të këtyre neneve.

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE (KPM)